



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMET E KURRIKULËS PËR SHKOLLËN E MESME TË GJUHËVE  
TË HUAJA (GJIMNAZ GJUHËSOR)**

**FUSHA: GJUHË E HUAJ**

**LËNDA: GJUHË ANGLEZE**

**KODI: 3.1.12.Zgj.(f)**

**PROGRAMI I LËNDËS  
GJUHË ANGLEZE  
PËR KLASËN E 12-TË**

**Koordinatore: Erifili Hashorva**

**Redaktore Letrare: Viola Grillo**

**Përgjegjëse sektori: Marita Hamza**

**TIRANË, NËNTOR 2010**

Programi i ri i gjuhës angleze për klasën e 12-të si gjuhë e tretë në shkollat e mesme të gjuhëve të huaja, është një përjasje e re dhe e domosdoshme për t'i dhënë një dimension të ri mësimi të kësaj gjuhe. Në tërë frymën e tij, programi përçon orientimin e ri për mësimin e gjuhës angleze si një gjuhë e huaj e rëndësishme dhe e detyrueshme në të gjitha hallkat e zinxhirit të sistemit tonë arsimor. Parë në këtë këndvështrim, roli i shkollave të mesme të gjuhëve të huaja merr një rëndësi domethënëse për t'u bërë përçues i të një praktike krejt të re në mësimdhënien e përvetësimit të gjuhës angleze në tërë komponentët e saj, për ta afruar më shumë nxënësin me realitetet e shanset e reja të krijuara.

Programi ofron mundësi e nxit forma të tilla pune që mësimi dhe përvetësimi i gjuhës angleze të jetë në funksion të objektivit madhor të integritit dinjitoz të nxënësve në një shoqëri demokratike e përmbushjes së kërkesave të tyre për një arsimim të mëtejshëm cilësor e të suksesshëm. Programi është vazhdimi logjik i njohurive të marra në klasën e 11-të, duke i ridimensionuar ato në përputhje me objektivat e caktuar. Ky program kontribuon në zhvillimin kompleks intelektual, kulturor e shoqëror të nxënësve të kësaj grupmoshe, ofron mundësi të reja për ta, që të zhvillojnë e zgjerojnë më tej elementet bazë të mësimi të gjuhës angleze për një përvetësim sa më të mirë praktik të kësaj gjuhe.

Mësimi i gjuhëve të huaja ndihmon në mënyrë të veçantë në formimin e përgjithshëm të nxënësit. Ai shton mundësitë shprehëse të tij, e pajis atë me mjetet dhe metodologjinë e përshtatshme të komunikimit.

Programi i klasës së 12-të reflekton njohuri gjuhësore, ndërlëndore dhe ndërkulturore të përfuara në klasën e 11-të, duke nxjerrë në pah baraspeshën e njohjes së gjuhës angleze me nevojën e nxënësit për t'i thelluar këto dije dhe, njëkohësisht, për të rritur aftësitë e tij shprehëse në gjuhën angleze.

Duke qenë se mësimi i një gjuhe është në të njëjtën kohë edhe njohje e kulturës apo e kulturave të tjera, ai bën të mundur edhe rritjen e horizontit kulturor e formues të nxënësit dhe ndikon drejtpërdrejt në formimin e personalitetit të tij.

Ai synon të zhvillojë të menduarit kritik dhe pavarësinë e nxënësit në kontekstin e klasës dhe jashtë saj, duke nxitur forma të ndryshme të punës individuale dhe të ndërveprimit në çifte e grupe.

Njohuritë e përfuara në këtë program, si pjesë përbërëse e kurrikulës së re të arsimit të mesëm të lartë, mundësojnë rritjen dhe forcimin e njohurive të nxënësit jo vetëm në gjuhën angleze, por edhe në lëndët e tjera, si p.sh., në lëndët e historisë, të gjeografisë, të biologjisë etj., duke i ndërthurur këto dije në mënyrë logjike. Kjo ndërthurje ndërlëndore fiton një dimension të ri në përpjekjen për të siguruar dije të qëndrueshme dhe të vazhdueshme. Këto dije e përgatitin nxënësin, gjithashtu, për t'u përballur me studime të mëtejshme, si dhe me situata punësimi brenda dhe jashtë vendit.

## 1. SYNIMI I LËNDËS

Programi i gjuhës angleze për nxënësit e klasës së 12-të i nivelit fillestar synon arritjen e nivelit **A2+**, **pra nivelit të mbijetesës gjuhësore** të Kuadrit të Përbashkët European të Referencës për Gjuhët. Në këtë fazë të formimit, qëllimi i gjuhës së huaj është të sensibilizojë nxënësit ndaj gjuhës dhe kulturës angleze, si edhe të formojë tek ata kompetencat bazë të komunikimit të një përdoruesi të aftësive gjuhësore.

Programi i gjuhës angleze për klasën e 12-të synon që nxënës/i,-ja të zhvillojë aftësitë bazë komunikuese dhe përdorimin e njohurive të përvetësuara për të plotësuar

nevoja konkrete në situata të jetës së përditshme. Gjithashtu ai/ajo duhet të ndërgjegjësohet për ndryshimet dhe kontrastet midis gjuhëve dhe të evidentojë ngjashmëritë dhe ndryshimet e sistemeve gjuhësore me atë të gjuhës amtare.

## 2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Programi i gjuhës angleze për klasën e 12-të, niveli fillestar, ka si objektiv të zhvillojë aftësinë perceptuese në përthithjen e një informacioni bazë gjuhësor e kulturor, duke e ndërthurur këtë informacion me njohuritë e lëndëve të tjera, ku nxënës/i,-ja:

- Të komunikojë lirshëm me shkrim dhe me gojë për të plotësuar nevoja konkrete;
- të shprehet saktë me shkrim duke përdorur një repertor strukturash;
- të jetë i aftë të përdorë saktë struktura të thjeshta dhe të kuptohet në një ndërhyrje të shkurtër;
- të jetë i aftë të bëjë dallimet ndërmjet kulturave të ndryshme për t'iu përshtatur situatave të komunikimit kulturor;
- të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendeve anglishtfolëse, vendeve të tjera, si dhe asaj amtare.

Objektivat e përgjithshëm përcaktohen e detajohen sipas aftësive të nxënësve në komunikim, në formim gjuhësor e kulturor. Ato vëzhgohen dhe maten nga mësuesit dhe vetë nxënësit.

Realizimi i këtyre objektivave është detyrim për përdoruesit e programit dhe për të gjithë nxënësit, që do të thotë se atyre u mundësohet nxënia e njohurive të përshkruara në objektiv.

## 3. OBJEKTIVA SIPAS STANDARDEVE

### a) Objektiva sipas standardit në komunikim

**Përshkrimi.** Ky standard hedh bazat e gjuhës, për nxënësit që e kanë vitin e dytë në ndërveprimin në gjuhën angleze.

Nëpërmjet situatave të ndryshme, të përshtatshme për grupmoshën dhe nivelin gjuhësor, ky standard i mundëson nxënësit të përftojnë njohuri gjuhësore të nevojshme për të përballuar situata të komunikimit të përditshëm në një mjedis gjuhësor e kulturor anglishtfolës.

Ky standard pasuron dijet e përgjithshme të nxënësit dhe e përgatit atë emocionalisht për një përballje reale me gjuhën dhe kulturën.

	Objektiva
<b>Komunikimi</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të prezantojë duke përshkruar njerëz të tjerë;</li> <li>• të kuptojë qëllimin e një informacioni;</li> <li>• të kuptojë informacionet bazë për veten dhe</li> </ul>

	<p>familjen;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të miratojë nëse ajo që thuhet është e drejtë;</li> <li>• të kundërshtojë;</li> <li>• të kërkojë shkëmbim informacioni të drejtpërdrejtë për çështje të njohura;</li> <li>• të shprehë pëlqimet dhe mospëlqimet;</li> <li>• të përshkruajë mjedisin rrethues;</li> <li>• të bëjë dallimin;</li> <li>• të klasifikojë;</li> <li>• të shprehë ndërvarjen e veprimeve, fakteve;</li> <li>• të tregojë;</li> <li>• të përsërisë;</li> <li>• të ndërveprojë;</li> <li>• të hartojë;</li> <li>• të përshkruajë;</li> <li>• të përmbledhë:</li> </ul> <p>në situata të ndryshme, si p.sh.: jeta e përditshme, vetja dhe familja, jeta në shkollë, bota rreth nesh, bota e komunikimit, jeta personale dhe shoqërore etj.</p>
	<b>Objektiva</b>
<b>Veprimtaritë e komunikimit</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kërkojë për informacione të ndryshme;</li> <li>• të kundërshtojë;</li> <li>• të japë leje;</li> <li>• të urojë duke përgëzuar;</li> <li>• të shprehë keqardhje dhe dëshira;</li> <li>• të kërkojë falje;</li> <li>• të nxisë;</li> <li>• të tregojë përvoja të ndryshme:</li> </ul> <p>në situata të jetës së përditshme, si: festa, takime, ditëlindje, treg, shkollë, mbrëmje, ekskursionet etj.</p>

## b) Objektiva sipas standardit në kulturë

**Përshkrimi.** Objektivat e standardit në këtë fushë parashikojnë fillimet e ndërgjegjësimit kulturor që udhëzojnë se nxënës/i,-ja i/e klasës së 12-të, pasi përfton njohuritë për elementet bazë të kulturës dhe i mishëron ato në mënyrën e prezantimit, përshkrimit, modelin e të treguarit të përvojës, të marrjes së fjalës, të dhënies së një këshille apo mendimi, të nxitet në njohjen e shprehive të një kulture tjetër dhe në vendosjen e kontakteve sociale bazë.

	<b>Objektiva</b>
<b>Kultura</b>	<p>Në fund të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shprehë lirshëm dhe qartë çështje të fushave të ndryshme;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të bëjë krahasimin ndërmjet elementeve të kulturës amtare dhe kulturës së huaj, duke përcaktuar dhe zbatuar strategji të ndryshme, si: gjeste, pasthirrma etj.;</li> <li>• të përshkruajë përvoja dhe ngjarje, ëndrra, shpresa dhe ambicie;</li> <li>• të përdorë rregullat e mirësjelljes popullore, gjuhën e të cilit mëson, sipas regjistrave bazë të gjuhës miqësore, konfidenciale, normale e informale;</li> <li>• të njohë artin, personalitete, ngjarje të rëndësishme të historisë dhe të aktualitetit.</li> </ul>
--	--

### c) Objektiva sipas standardit në formimin gjuhësor

**Përshkrimi.** Ky standard aftëson nxënës/-in,-sen të prodhojë elemente gjuhësore që i përkasin nivelit A2+. Strukturat gjuhësore në këtë nivel janë mesatare dhe realizohen nëpërmjet situatave të ndryshme ligjërimore, ku nxënës/i, -ja nxitet të praktikojë fjali dhe shprehje të gjuhës angleze, si dhe të kuptojë lidhjen dhe përdorimin e saktë të tyre në ligjërimin me gojë dhe me shkrim.

	<b>Objektiva</b>
<b>Elemente gramatikore</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përshkruajë;</li> <li>• të komunikojë;</li> <li>• të shkruajë;</li> <li>• të krijojë;</li> <li>• të riprodhojë;</li> <li>• të përdorë: foljet e parregullta në kohën e tashme, të shkuar e të ardhme dhe në formën veprare; ligjëratën e drejtë; format me <i>-ing</i> të foljeve; lidhëzat; folje frazë; foljet modale; përemrat vetorë, dëftorë, pyetës dhe pronorë; rendin e fjalëve në fjali; mbiemrat e format e tyre; ndajfoljet; nyjet; parafjalët; nëpërmjet situatave të ndryshme nga jeta e përditshme.</li> </ul>

## 4. OBJEKTIVA SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

<b>Aftësia</b>	<b>Objektiva</b>
<b>Të dëgjuarit</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kuptojë frazat, fjalitë dhe shprehjet që lidhen me fushat e interesit të tij rastësor, si: informacione për veten dhe familjen e tij, për vendbanimin, klasën e shkollën, shpjegime si të shkojë në treg, për</li> </ul>

	<p>veprimtaritë që ai bën etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të kapë thelbin në mesazhe të shkurtra e të thjeshta, si dhe në njoftime shkollore;</li> <li>• të kuptojë thelbin e bisedave rreth temave të jetës së përditshme;</li> <li>• të ndjekë pa treguar hezitim udhëzime që tregojnë drejtim, si dhe pikat orientuese etj;</li> <li>• të reagojë ndaj udhëzimeve të drejtuara në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë;</li> <li>• të kuptojë në përgjithësi përmbajtjen e informacionit në materiale të regjistruara (CD, kaseta audio ose video), tema e të cilave është e interesit personal dhe me gjuhë të qartë dhe standarde;</li> <li>• të shprehë qartë çmimet, numrat dhe orën.</li> </ul>
<b>Të lexuarit</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të dallojë informacionet kryesore në përmbledhjen e lajmeve apo të artikujve të thjeshtë të gazetave, kur janë të shkruara dhe të ilustruara e të strukturuar qartë;</li> <li>• të kuptojë një letër të thjeshtë, në të cilën letërshkruesi shkruan ose pyet për aspekte të ndryshme të jetës së përditshme;</li> <li>• të kuptojë mesazhe të shkurtra në kompjuter;</li> <li>• të kuptojë komandat më të rëndësishme të një programi kompjuterik, si: printim, ruajtje, kopjim etj.;</li> <li>• të kuptojë mesazhe të shkurtra përmes e-mail-it dhe letrës.</li> </ul>
<b>Të folurit</b>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të marrë pjesë në një bisedë ku kërkohet informacion duke bërë veprime të thjeshta në dyqan, në postë etj.;</li> <li>• të marrë pjesë pa hezitime në diskutime mbi tema të njohura;</li> <li>• të ftojë dikë, duke reaguar ndaj ftesave që i bëhen;</li> <li>• të përshkruajë mjedisin që e rrethon në shtëpi, në klasë, në shkollë etj.;</li> <li>• të shprehë me mirësjellje miratimin/mosmiratimin e udhëzimeve të dhëna në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë;</li> <li>• të transmetojë informacione, duke i kërkuar në mënyrë të thjeshtë dikujt t’i përsërisë diçka;</li> <li>• të shprehet me një fjalor të pasur, me një shqiptim të mirë e përgjithësisht të saktë mbi tema të përditshme, si shkolla, udhëtimet etj.;</li> <li>• të japë sqarime në situata të parashikuara;</li> <li>• të shprehë mendimin personal në diskutime me shokët mbi tema të interesit të përbashkët, duke përdorur shprehje e fjalë të thjeshta.</li> </ul>

<p><b>Të shkruarit</b></p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shkruajë qartë tekste të shkurtra mbi tema të interesit vetjak;</li> <li>• të përshkruajë një ngjarje të vërtetë, me fjalor të thjeshtë për shkrimet treguese;</li> <li>• të kërkojë me shkrim informacion të thjeshtë e të nevojshëm për shërbime vetjake të ndryshme, duke paraqitur kërkesën e tij për këtë shërbim;</li> <li>• të përshkruajë thjesht e saktë përmbajtjen e një tregimi apo paragrafi të shkurtër, duke dhënë mendimin e tij personal;</li> <li>• të shkruajë me gjuhë të thjeshtë letra rreth përvojave të veta duke shprehur ndjenjat, si: gëzim, trishtim, habi, keqardhje etj.;</li> <li>• të bëjë shënime të shkurtra, për të lënë një mesazh;</li> <li>• të plotësojë një pyetësor me informacion rreth shkollimit, moshës, kombësisë dhe interesave të tij/saj;</li> <li>• të transmetojë përmes mediave elektronike një informacion të thjeshtë e të nevojshëm.</li> </ul>
----------------------------	--

## 5. KËRKESA TË GJUHËS ANGLEZE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Programi i gjuhës angleze për klasën e 12-të për nivelin fillestar mbështetet në integrimin ndërlëndor, përmes njohurive gjuhësore të trajtuara në kontekste kuptimore parashtruar në fusha tematike që ndërthuren edhe me lëndët e tjera.

Njohuritë e përgjithshme, si dhe ato të lëndëve të tjera që ndërthuren me ato të gjuhës angleze, u paraprijnë njohurive gjuhësore të gjuhës angleze të përshkruara dhe të parashtruara në këtë program.

Në këtë nivel gjuhësor, nxënës/i,-ja nuk ka kërkesa të veçanta për lëndët e tjera, mbasi nuk i mundëson formimi gjuhësor i anglishtes.

Programi i gjuhës angleze për nivelin fillestar ka integrim ndërlëndor, i cili lidhet ngushtë me njohuritë që nxënësit marrin në lëndë të ndryshme, si:

**Gjeografia**, njohuritë e së cilës mund të japin informacion, p.sh., për vendet turistike në Britaninë e Madhe, SHBA, Kanada etj., duke lehtësuar kuptimin e temave mbi turizmin, zakonet turistike, kulturën e pushimeve apo të kohës së lirë, interesat, parapëlqimet, shijet që lidhen me to etj.

**Sociologjia**, e cila mund të lehtësojë kuptimin e dokeve, zakoneve, vlerave shoqërore të një populli të huaj, që kushtëzohen nga një kontekst shoqëror dhe nga një realitet i ndryshëm nga i yni. Vetë njohja e gjuhës së huaj dhe e një kulture të huaj kultivon te nxënës/i,-ja ndjenja të tolerancës, pranimit të shumëllojshmërive etj., që lidhen ngushtë me zbatimin e të drejtave të njeriut dhe edukimin qytetar.

**Historia**, e cila, me ngjarje dhe fakte të mëdha, mund të ndihmojë në formimin kulturor e intelektual të nxënës/it,-es, njohjen e vlerave historiko-shoqërore të vendeve anglishtfolëse, personaliteteve të shquara, ngjarjeve të mëdha historike etj.

Trajtimi ndërlëndor u shërben synimeve të përgjithshme të programit për:

*Edukimin intelektual.* Përmes ndërthurjes së njohurive të ndryshme, nxënësit arrijnë të krahasojnë, të kundërshtojnë, të dallojnë dhe të hamendësojnë, duke rritur cilësinë e nxënies.

*Edukimi mjedisor.* Ndotja dhe mbrojtja e ambientit janë tema që shoqërohen me fjalor e struktura gjuhësore të thjeshta, të cilat trajtohen jo si një qëllim më vete, por në një kontekst kuptimplotë dhe edukativ.

*Edukimi kulturor dhe etik.* Përmes lëndëve historike dhe gjeografike, nxënësit fitojnë njohuri mbi vendet anglishtfolëse. Këto njohuri bazë ndërthuren me dijet mbi kulturën e këtyre vendeve, zakonet e doket e tyre, mënyrën e jetesës etj. Përmendim këtu edhe shprehjet etike të këtyre popujve. Nxënësit mësohen të ndërveprojnë në situata të ndryshme me sjellje etike të përshtatshme, që trajtohen përmes funksioneve gjuhësore të thjeshta, si: të kërkojnë falje, sqarime, të pyesin etj.

*Edukimi për të drejtat e njeriut.* Njohja e kulturave të vendeve anglishtfolëse trajtohet ngushtë me temat e barazisë sociale e gjinore.

## **6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT**

Programi i klasës së 12-të për nivelin fillestar është dokument zyrtar dhe, si i tillë, ai është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjithë përdoruesit e tij (mësues, nxënës, drejtues të arsimit në shkollat e arsimit të mesëm, inspektorë të gjuhës angleze në njësitë arsimore vendore). Ky program mbështet në dokumente të rëndësishme, si:

- Kuadri i Përbashkët Europian i Referencave për Gjuhët e Huaja.
- Kurrikula Kombëtare e Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar.

### **A. Objektivat**

Bazuar në orientimet mbi objektivat e arritjeve në procesin mësimor, është e rëndësishme që mësuesi të përshtatë veprimtarinë mësimore në varësi të niveleve të ndryshme që nxënësit kanë në gjuhën angleze.

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit dhe janë detyrim për përdoruesit e programit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë atë që përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

### **B. Orët mësimore**

Programi i gjuhës angleze për klasën e 12-të për fillestarë është strukturuar në përshtatje me objektivat sipas standardit në komunikim, kulturë, formim gjuhësor dhe aftësi gjuhësore. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, por janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e përcaktuara.

Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt, kur ata demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.



Në programin e lëndës së gjuhës angleze, afërsisht **70%** e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe **30%** e tyre janë për rimarrjen dhe përpunimin e njohurive (gjatë vitit shkollor dhe në fund të tij).

### **Shpërndarja e orëve mësimore**

Gjuha angleze për klasën e 12-të në shkollën e mesme të gjuhëve të huaja zhvillohet me 3 orë mësimore në javë (**34 javë x 3 orë = 102 orë vjetore**) dhe shpërndarja e orëve të planifikuara është si vijon:

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst, fushat dhe aftësitë gjuhësore ndërthuren me njëra-tjetrën. Mësuesi është i lirë të bëjë kombinimin e tyre brenda një njësie mësimore, pavarësisht renditjes në tabelën e shpërndarjes së orëve.

Shpërndarja e orëve të planifikuara është si vijon:

**Komunikimi dhe formimi kulturor zë 71 orë**, të cilat ndahen, sipas objektivave që u përgjigjen, në 50 orë mësimore për kulturën dhe komunikimin (70% e tyre, që përbëjnë 35 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 15 orë, do të shërbejnë për përpunimin e njohurive. Me përpunim do të kuptojmë, p.sh., përforcimin e informacionit të marrë në temat përkatëse ose ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni). Aktet dhe funksionet e komunikimit do të jenë 21 orë (70% e tyre, që përbëjnë 15 orë mësimore, do të shërbejnë për njohuritë e reja, kurse 30% e tyre, d.m.th. 6 orë mësimore, do të përdoren për përpunimin e njohurive. Këtu mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës, d.m.th. ai jep detyra komplekse, ku pasqyrohen njohuritë e përfutuara sipas aftësive dhe objektivave në një kapitull).

**Formimi gjuhësor zë 31 orë**. Janë kryesisht orë, në të cilat mësuesi shtjellon, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (70% e tyre, që përbëjnë 22 orë mësimore, do të shërbejnë për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 9 orë, do të shërbejnë për rimarrjen, përpunimin dhe përforcimin e tyre).

**Përpunimi i njohurive** ka si qëllim rimarrjen dhe përforcimin e informacionit të marrë gjatë trajtimit tematik të përmbajtjes ose përsëritjen e elementeve të ndryshme gjuhësore.

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen e njohurive bazë (konceptet themelore);
- testimin e njohurive bazë;
- integrimin e njohurive të reja të lëndës me njohuritë e fituara më parë.

Gjatë përpunimit të njohurive bazë duhet t'i kushtohet kohë e posaçme:

- kultivimit të aftësive të përgjithshme, si: të komunikimit, të manaxhimit të informacionit, të zgjidhjeve problemore dhe të menduarit kritik e krijues;
- kultivimit të aftësive gjuhësore: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit;
- formimit të qëndrimeve, si qëndrimin etiko-social dhe qëndrimi gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të nxiten nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike e projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

### **Metoda dhe strategji të mësimdhënies/nxënies**

Programi i klasës së 12-të për nivelin fillestar orienton gjithë procesin e mësimdhënies e të nxënies së gjuhës angleze në nivelin A2+.

Mësuesi është i lirë të përdorë larmi metodash e strategjish të mësimdhënies/nxënies për t'ua përshtatur nevojave të nxënësve në klasa të ndryshme. Ai/ajo i kombinon këto metoda gjatë procesit mësimor dhe i përshtat ato në bazë të zhvillimit në rritje të kompetencave gjuhësore dhe të zhvillimit të pavarësisë së nxënësit në vijueshmëri të këtij procesi.

### **Të dëgjuarit**

Për të zhvilluar aftësinë e të dëgjuarit, nxënësi ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të mbajë shënime gjatë dëgjimit.
- Të klasifikojë çështjet që dëgjon.
- Të përqendrohet e të zbulojë detaje kryesore.
- Të kuptojë çfarë flitet në ambiente të ndryshme.
- Të bëjë lidhje mes asaj që dëgjon dhe materialit vizual.
- Të dëgjojë disa herë një tregim, këngë etj., për të kuptuar idenë kryesore, duke u përqendruar në fjalët që njeh.
- Të përqendrohet te kërkesa e dëgjimit.
- Të vërë qëllime dhe objektiva për zhvillimin e aftësisë së dëgjimit.

### **Të folurit**

Për të zhvilluar aftësinë e të folurit, nxënësi ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- T'i kërkojë folësit të përsërisë çfarë tha, në rast moskuptimi.
- Të kërkojë ndihmën e bashkëfolësit, kur nuk di kuptimin e ndonjë fjale apo shprehjeje.
- Të përdorë shprehje, si: *Mm, well* dhe pauza, gjeste etj., me qëllim që të fitojë kohë në gjetjen e fjalës së duhur.
- Të përsërisë një pjesë të asaj që thotë bashkëfolësi, për t'u siguruar për kuptimin e mesazhit që përcillet.
- Të pyesë bashkëbiseduesin për të bërë të qartë atë që është thënë.
- Të bëjë bisedë të ndërsjellë me bashkëbiseduesin.

## **Të lexuarit**

Për të zhvilluar aftësinë e të lexuarit, nxënësi ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të kërkojë të dhëna që e ndihmojnë për të parashikuar përmbajtjen e tekstit, si: figura, titulli i mësimit etj.
- Të lexojë tekstin për herë të dytë, që të hamendësojë kuptimin e fjalëve të panjohura.
- Të lexojë pyetjet rreth tekstit dhe të mendojë për përgjigjet e mundshme.
- Të gjejë në tekst përgjigjet e pyetjeve, duke iu rikthyer disa herë leximit.
- Të lexojë tekstin dhe të nxjerrë kuptimin kryesor.

## **Të shkruarit**

Për të zhvilluar aftësinë e të shkruarit, nxënësi ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të mbajë shënime për informacionin që i duhet të përfshijë në detyrën e caktuar.
- Të planifikojë paragrafët duke shkruar idenë kryesore të secilit paragraf.
- Të plotësojë paragrafët me informacion mbështetës, si: shembuj, sqarime etj.
- Të kontrollojë lidhjen logjike të paragrafëve, duke përdorur lidhëzat përkatëse.
- Të këmbëjë punën e tij me atë të shokut.

## **C. Parime për zbatimin e programit**

Zbatimi i programi mbështetet në parimet e mëposhtme:

### **Vendosja e nxënës/-it,-es në qendër të vëmendjes**

Programi merr parasysh nxënësin, njohuritë e tij, aftësitë e grupmohës, interesat, talentin dhe përvojat vetjake. Kjo reflektohet, së pari, në përzgjedhjen e temave që trajtohen; së dyti, në përdorimin e strategjive që e nxisin nxënësin të veprojë me gjuhën; së treti, në përfshirjen e tij në vlerësimin dhe vetëvlerësimin e dijeve të përfutuara.

### **Krijimi i mjedisit të të nxënit**

Krijimi i një mjedisi shkollor fizik, emocional dhe jofrenues për procesin mësimor, ku nxënësi ndihet i sigurt, mundëson një mësimdhënie/nxënie që plotëson nevojat dhe objektivat e përcaktuar më parë.

### **Organizimi i klasës**

Mësuesi përdor mënyra të ndryshme të organizimit të klasës, që krijojnë e ruajnë një mjedis mbështetës dhe rrisin motivimin e nxënësve. Organizimi i mësimit mundëson punën në grupe dhe nxit lirshmërinë e nxënësve. Atyre u krijohen mundësi dhe lehtësi për të eksploruar në gjuhë, për të eksperimentuar në të, për ta përdorur atë në përputhje me nevojat e tyre. Atmosfera e klasës është mbështetje dhe respekt për përgjigjen e nxënësit si nga mësuesi, ashtu edhe nga nxënësit e tjerë. Nxënësi

ndërkohë mëson edhe nga shokët e tij. Herë pas here nxënësi punon në mënyrë të pavarur, duke menduar vetë për zgjidhjen e një problemi.

### **Të mësuarit bashkëveprues**

Nxënësit, gjatë orëve të gjuhës së huaj, shpesh nxiten të punojnë së bashku. Detyrat e përbashkëta u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur me njëri-tjetrin, ndihmojnë të folurit e rrjedhshëm dhe zhvillojnë shkathtësi sociale. Njëherazi edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe ndihmon, gjithashtu, në shoqërizimin e nxënësve, i bën ata bashkëveprues me njëri-tjetrin dhe me mësuesin, nxit tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike për të ndarë punën dhe përgjegjësitë.

### **Përdorimi i gjuhës në klasë**

Gjuha angleze është mbizotëruese gjatë orës së mësimit. Mësuesi, që është nxitësi dhe mbështetësi kryesor i përdorimit të gjuhës angleze në klasë, minimizon në maksimum përdorimin e gjuhës amtare.

### **Të mësuarit e gramatikës**

Nevojat e veçanta për komunikim mbështeten në gramatikën komunikuese. Nxënësit mësojnë gramatikën në shërbim të komunikimit. Në këtë nivel jepet një sasi e vogël rregullash gramatikore për t'u mësuar, gjithmonë në mënyrë të tillë që nxënësit të mund të përdorin format gramatikore për qëllime komunikimi. Gramatika jepet dhe mësohet në mënyrë induktive nëpërmjet materialeve autentike. Nxënësit, gjatë gjithë procesit të nxënies, ekspozohen ndaj dukurive të reja gramatikore.

### **Korrigjimi i gabimeve**

Gabimet duhet të korrigjohen, por kjo në kohën dhe vendin e duhur. Vërejtjet, këshillat dhe korrigjimet e mësuesit, të shokëve ose dhe të vetë nxënësit ndihmojnë për të nxitur vetëbesimin dhe vetërespektimin. Qortimi pa kriter mund të çojë në frenimin e iniciativës, heqjen e dëshirës për të folur, shkurajimin, madje mund të rrezikojë edhe ecurinë e mëtejshme të mësimit. Mësuesi ndërhyt me takt, dhe, duke përdorur forma të larmishme, qorton më shpesh kur nxënës/-it,-et praktikojnë strukturat gramatikore dhe më rrallë kur nxënësit janë duke punuar në grup, kur janë duke debatuar apo duke diskutuar për tema të ndryshme.

### **Puna e diferencuar me nxënësit**

Me qëllim që metodat e mësimdhënies dhe të nxënies dhe parimet e strategjitë mbi të cilat realizohen këto metoda të kenë arritje sipas standardeve të përcaktuara, mësuesi planifikon punën e diferencuar me nxënësit.

Duhet të pranohet se niveli i formimit të aftësive të nxënësve që njihen me programin e gjuhës angleze të klasës së 12-të nuk është i njëjtë për të gjithë nxënësit. Arritja e rezultateve të kërkuara nga programi për të gjithë nxënësit kërkon që mësuesi të marrë parasysh nivelet e ndryshme që ekzistojnë në klasë. Kjo gjë ndodh për arsye objektive ose subjektive. Prandaj, mësuesi planifikon punën e tij të

diferencuar lidhur me metodat e mësimdhënies, me ecurinë e nxënësve gjatë gjithë procesit mësimor, si dhe me format e ndryshme të vlerësimit.

Mësuesi njihet mirë që në fillim me përbërjen e klasës së tij dhe me problemet që kanë nxënësit. Mësuesi ka të bëjë me adoleshentë dhe, për këtë arsye, ai ndeshet edhe me shumë probleme të moshës së tyre, si: temperament impulsiv, të ashpër në komunikim, ndonjëherë agresiv, dorëzim para një detyre të dhënë etj.

Me qëllim që t'i tërheqë të gjithë nxënësit në mësim, mësuesi duhet të përdorë disa mënyra didaktike, si:

- Të ketë vullnetin dhe dëshirën për t'i dëgjuar dhe për t'u dhënë përgjigje nxënësve;
- të ndjekë sjelljen e nxënësve në çdo hap, brenda dhe jashtë orës së mësim;
- të ndajë përgjegjësitë, atje dhe atëherë kur duhet, për çështje vendimmarrjeje, detyra shtëpie apo klase, detyra me shkrim etj.;
- të japë vazhdimisht përshkrime të punës së nxënësve;
- të kërkojë prej nxënësve vlerësime të punës së tij, me qëllim që të reflektojë ndaj dobësive.

Nxënësit kanë nevojë për një siguri profesionale dhe njerëzore në klasë, prandaj mësuesi përdor metoda të larmishme dhe gjithëpërfshirëse demokratike, duke siguruar një mjedis të rregullt brenda normave dhe rregullave të shkollës.

## 7. VLERËSIMI

Zbatimi me korrektësi i udhëzimeve për përdorimin e programit të klasës së 12-të bën të mundur vënien në praktikë të një mënyre vlerësimi bashkëkohore të dijeve të nxënës/it,-es, d.m.th. me bazë vlerësimin komunikativ me shkrim dhe me gojë gjatë gjithë procesit mësimor. Kjo metodë vlerësimi, mbështetur në Kuadrin e Përbashkët Europian të Referencave për Gjuhët dhe në Portofolin Europian për Gjuhët, jo vetëm përshkon gjithë procesin mësimor, por shërben edhe për përmirësimin e këtij procesi.

Kur vlerësimi mbështetet në aktivitetet e organizuara në klasë, të parashikuara në program, në përputhje me objektivat e tij, ai siguron:

- Një matje të rregullt të ecurisë së nxënës/it,-es në gjuhën angleze;
- një informacion për rivlerësim të përmbytjes lëndore, si dhe cakton detyrat për të ardhmen;
- një përmirësim të njohurive të nxënës/it,-es;
- një përgjegjshmëri të të gjithë pjesëmarrësve në procesin e mësimdhënies/nxënies (nxënës, mësues të gjuhës angleze dhe ndërlëndorë, drejtori shkolle, inspektor i arsimit për gjuhën angleze dhe detyrimisht edhe prind).

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënës/in,-en për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi, dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Vlerësimi i nxënës/it,-es duhet të jetë objektiv dhe i matshëm. Asgjë nuk është më nxitës, sesa sukcesi i arritur, duke u përballur me gjendjen reale në të

cilën ndodhet një nxënës/e. Mësues/i,-ja monitoron dhe vlerëson detyrat, duke përcaktuar objektiva të qartë. Ai/ajo përdor vetë dhe ndihmon edhe nxënësit që të përdorin një larmi mënyrash vlerësimi.

Vlerësimi mund të organizohet në disa forma:

*Vlerësimi i dijeve* (ose i niveleve), ku përfshihet vlerësimi i objektivave specifike. Ky vlerësim ka lidhje me atë që është mësuar gjatë një jave, një muaji ose një semestri, pra me punën që është bërë me tekstin dhe programin. Vlerësimi i dijeve është i bazuar në orën e mësimit. Kështu, ai i përgjigjet një vështirimi të brendshëm. Ky lloj vlerësimi është pozitiv për faktin se është më afër përvojës së nxënës/it,-es

*Vlerësimi i kapaciteteve* (ose i zbatimit të aftësive, ose i performancës), që është vlerësimi i asaj çfarë nxënësit mund të bëjnë ose dinë në raport me zbatimin e saj në jetën e përditshme dhe i lejon çdonjërit të pozicionohet aty ku e meriton, pasi rezultatet janë më se të dukshme.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij/saj me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarive e produkteve të tjera, si, një maket etj.

*Vlerësimi me shkrim dhe me gojë* klasifikohet në:

*Vlerësim formues*, me anë të të cilit merret informacion rreth asaj që është arritur nga nxënës/i,-ja në formimin e tij/saj gjuhësor, në përputhje me objektivat e caktuar.

*Vlerësim diagnostikues*, i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme, për të marrë informacion rreth përgatitjes ditore dhe përvetësimit të materialit gjuhësor të dhënë më parë. Gjithashtu, ai jep informacion për efektivitetin e të nxënësit dhe ndihmon në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies/nxënies.

*Vlerësim i planifikuar* mbi bazën e realizimit të objektivave të fushës, pra në bazë kapitulli. Ky vlerësim bëhet me notë dhe realizohet në fund të çdo mësimi përsëritës.

*Vlerësim motivues*, i cili ndihmon për të nxitur dëshirën e nxënës/it,-es për mësimin e gjuhës angleze. Ky vlerësim është i vazhdueshëm dhe gjatë gjithë procesit mësimor. Mësues/i,-ja realizon këtë lloj vlerësimi, duke gjetur shprehjet e duhura motivuese, si: *mirë, shumë mirë, all right*, etj., dhe duke përdorur materiale që nxënësit vlerësimin motivues të nxënësit, p.sh., përgatitja e dosjes së arritjeve të nxënës/it,-es si pjesë e portofolit evropian të gjuhëve, ku nxënës/i,-ja vendos certifikata, provime, projekte, dëshmi etj. që provojnë ecuri të tij/saj në gjuhë.

### **Vlerësimi përfundimtar**

Në përfundim të semestrit të parë, për çdo nxënës/e dhe lëndë përllogaritet nota semestrale dhe në përfundim të vitit shkollor, nota vjetore. Nota e semestrit të parë dhe ajo vjetore përllogariten duke pasur si të dhëna fillestare të gjitha notat e nxënës/it-es të shënuara në regjistër. Notat gjatë vitit shkollor nuk kanë të njëjtën peshë në njehsimin e notës semestrale dhe asaj vjetore. Pesha e një note përcaktohet nga lloji i notës.

Janë katër lloje notash:

- Nota e vlerësimeve të përditshme,
- nota e provimeve periodike me shkrim,
- nota e punimeve të nxënësve,
- nota e provimit përfundimtar (nëse mësuesi e zhvillon edhe këtë).

#### **Duhet treguar kujdes, që:**

- Para testimit të bëhet një model, që t'u tregohet nxënësve se si do të jetë testimi.

- Caktohen më parë qëllimet e testimit, për të kaluar më pas në zhvillimin e tij.
- Vlerësimi mund të jetë individual ose në grup.
- Në rastet kur testet hartohen me pyetje të llojeve të ndryshme, ato grupohen sipas llojit të tyre, p.sh.: pyetje me zgjedhje të shumëfishtë bashkë, pyetje me çiftim bashkë e kështu me radhë.
- Është mirë që pyetjet në test të renditen sipas shkallës së vështirësisë. Zakonisht në një test (p.sh., në fund të një kapitulli) kërkohet që 40% të pyetjeve të jenë të nivelit të parë, 40% të nivelit të dytë dhe 20% të nivelit të tretë. Numri i pyetjeve në test varet nga ajo që duhet testuar (një mësim, një kapitull apo një koncept).

#### *Disa udhëzime për vlerësimin*

Është e domosdoshme që mësues/i,-ja të mos përdorë vetëm një formë vlerësimi, por larmi formash, që t'u krijojnë nxënësve mundësi të vlerësohen në atë mënyrë që është e përshtatshme për çdo individ. Kështu, p.sh., një nxënës/e përgjigjet më mirë me gojë, një tjetër me shkrim; njëri i shpreh bukur dhe me emocion mendimet në një pyetje të hapur, një tjetër jo.

Vlerësimet e përfundimeve të nxënësve të trajtohen me kompetencë e jo si mesatare aritmetike e notave të vlerësimit formues.

Duhet të kemi parasysh që përparimi i nxënës/it,-es dhe një gjykim përmbledhës në përfundim të periudhës bazuar në objektiva, përbën vlerësimin përfundimtar. Vonesat e dhënies së përfundimeve të vlerësimit dhe analiza e tyre nga mësues/i,-ja e ulin shumë vlerën e korrigjimit të gabimeve.

Shënime të jenë të thjeshta, por të pasura. Është e domosdoshme që përveç regjistrimit të klasës, mësues/i,-ja të mbajë shënime të tjera për punën e çdo nxënës/i,-eje. Ato ndihmojnë në njohjen dhe në vlerësimin e arritjeve, në diagnostikimin e në riparimin e vështirësive dhe lehtësojnë vlerësimet përmbledhëse.

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi në lëndën e gjuhës së huaj do të fokusohet në aftësinë e zotërimit të koncepteve kyç të gjuhës së huaj dhe në zbatimin e këtyre koncepteve. Vlerësimi i aftësive do të vërë theksin në sjelljen e nxënësve në një punim të caktuar, sjelljen në grup dhe aftësinë e tyre për të përdorur burime të ndryshme për marrjen e informacionit në gjuhë të huaj, si dhe vlerësimin në mënyrë kritike të këtij informacioni.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike e sociale, në përgjithësi, dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë, si dhe ndihmon nxënësit dhe, së bashku, zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Metodat e vlerësimit të përdorura në gjuhë të huaj do të përfshijnë:

- Teste me shkrim për të kontrolluar arritjet e nxënësve në lidhje me objektivat e programit,
- monitorimin e punës në grup të nxënësve,
- punët eksperimentale, raportet e punës,
- projektet, prezantimet e kërkimeve.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore.

Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të materialeve mësimore të zhvilluara në klasë dhe kryerjes së detyrave jashtë klase. Herë pas here, mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve, që në fillim, qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e nxënësve në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike. Mësues/i,-ja vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të zhvilluara vetë ose në grup. Mësues/i,-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një apo disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai/ajo përdor lloje të ndryshme testesh, që nga testet disaminutëshe për një objektivi të veçantë të të nxënësve, tek ato njëorëshe. Planifikohen teste me alternativa ose me zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Vlerësimi në gjuhë të huaj do të fokusohet në aftësitë e nxënësve në lidhje me të kuptuarit dhe përdorimin e këtyre njohurive.

Portofoli i nxënës/it.-es, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor për lëndën. Portofoli i nxënës/it.-es mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënës/i,-ja, ndërsa mësues/i,-ja rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të nxënësve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësues/i,-ja, duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, përjashtuar vlerësimin me shkrim apo me gojë.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti sipas detyrave të tij/saj në grup.

### **Vetëvlerësimi:**

Vetëvlerësimi është një tjetër element i rëndësishëm i vlerësimit në mësimin e gjuhës angleze, ku secili nxënës/e jep gjykimin për zotësinë e vet. Vetëvlerësimi është një plotësues i domosdoshëm i vlerësimit nga mësues/i,-ja dhe nga provimet, madje dhe nga prindërit e institucione të tjera vlerësuese.

### **Vetëvlerësimi ka efekt, kur:**

- U referohet normave dhe kapacitetit që Kuadri i Referencave për Gjuhët parashtron për grupmoshën e nivelin e tyre,
- është i lidhur me një përvojë të veçantë gjuhësore e ndërkulturore.

Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin e nxënësve në vazhdimësi. Si mjet në vlerësim dhe vetëvlerësim shërben Portofoli European i Gjuhëve (PEGj) që, me anë të tri pjesëve të tij (Pasaportës Gjuhësore, Bibliografisë Gjuhësore dhe Dosjes) nxit nxënësin të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor, duke vetëvlerësuar njohuritë e marra dhe dokumentimin e arritjeve të tij gjuhësore, të cilat mund të jenë: provime me shkrim, detyra tematike, certifikata, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare.



PEGj-i është dokumenti që çdo nxënës që mëson një gjuhë, ose ka mësuar një gjuhë, në shkollë ose jashtë saj, mund të shënojë njohuritë e tij gjuhësore dhe eksperiencat kulturore. PEGj-i nxit çdo nxënës të mësojë më shumë gjuhë, edhe në nivele modeste, dhe të vazhdojë t'i mësojë ato gjatë gjithë jetës. PEGj-i nxit nxënësin të përmirësojë mësimin dhe kapacitetin e vlerësimit të aftësive të tij në fushën e gjuhëve. Përdorimi i PEGj-it favorizon lëvizjen në Europë, duke informuar aftësitë për gjuhët në mënyrë të qartë dhe të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. PEGj-i kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Europë nëpërmjet eksperiencës së kulturave të tjera dhe me ndihmën e kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

- Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas mësues/i,-ja dhe nxënësit bëjnë komentim përfundimtar.
- Nxënësit, gjithashtu, vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit.
- Nxënës/i,-ja mban shënim arritjet e tij/saj, duke përdorur edhe gjuhën amtare.
- Mësues/i,-ja bisedon me nxënës/in,-en individualisht dhe i tregon arritjet.
- Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin se ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi; ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe, në këtë mënyrë, të organizojnë më mirë të nxënësit e tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënës/i,-ja, ashtu dhe mësues/i,-ja.